



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Në bazë të nenit 5, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (**Ligji i AKP-së**), dhe kapitullit 3, të Politikave Operative të AKP-së, Agjencia Kosovare e Privatizimit ("**AKP**") si administratore me mirëbesim, përcakton statusin e ndërmarrjeve dhe aseteve të saj në territorin e Kosovës, në bazë të dokumentacionit dhe dëshmime në dispozicion. Lidhur me këtë me datë 11 maj 2017 shpallë këtë:

NJOFTIM

Në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. Ref. 90/5, të datës 27 prill 2017:

Ndërmarrja "Organizata Punuese Mirëmbajtja Ndërtimore" Zveçan në Zveçan KK Zveçan; e njohur edhe me emrin OTHPB "Mirëmbajtja Ndërtimore" në Zveçan KK Zveçan, është 100 % pronë shoqërore dhe bie nën kompetencat administrative të Agjencisë.

Shënim i rëndësishëm:

Agjencia pas përcaktimit të statusit të ndërmarrjes, e cila bie nën kompetencën administrative të saj fillon me procesin e likuidimit/shitjen e ndërmarrjes dhe aseteve të saj, pas të cilit proces në mes tjerash realizohen edhe pagesat nga mjetet financiare nga shitja e tyre për "Kreditorët" dhe "punëtorët e kualifikuar" deri në shumë në të cilën të njëjtit kanë të drejtë.

Palët e interesuara pas shpalljes së këtij njoftimi mund të ushtrojnë ankesë kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në Prishtinë për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ligji përkatës i AKP-së gjendet në faqen e internetit të AKP-së <http://www.pak-ks.org> apo drejtpërdrejtë në <http://www.assembly-kosova.org/>